



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 140 dhe 141 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/145
Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën dhe Plani i Veprimit për vitin 2013-2018.
2. Obligohet Ministria e Diasporës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Organizativ për Shënimin e Ditës së boshnjakëve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 15,000.00 (pesëmbëdhjetë mijë) euro për festimin e 28 shtatorit, ditës së komunitetit Boshnjak në Kosovë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara kategoria e rezervës dhe barten në xhirollogarinë e Këshillit Organizativ për Festën memoriale të Boshnjakëve nr. 1120194172000176 në bankën komerciale Pro Credit Bank.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndarjen e mjeteve financiare shtesë në shumë prej 161.200.00 (njëqindëgjashtëdhjetenjë mijë e dyqind) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Ministrisë së Administratës Publike, nën-programi me kod 203 "Departamenti për menaxhimin e RAP", kategoria ekonomike - Paga dhe mëditje dhe barten në programin e Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje.
3. Këto shtesa realizohen nga data e shpalljes së zgjedhjeve deri 15 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Administratës Publike, Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për kompensim shtesë.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin 2013.
3. Këto shtesa realizohen nga 1 shtator 2013 e deri 15 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe me Ligjin nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, për anëtar të Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës, i propozon Kuvendit këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Ujup Krasniqi dhe
 - 1.2. Z. Ismail Osdautaj;
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që vendimin, së bashku me biografitë e kandidatëve, t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/145

Datë: 26.08.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 gusht 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Kosovës për bashkëpunimin në zbatimin e asistencës në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Integritit Evropian që të zhvilloj negociata me UNDP-në, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë